

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përfshihet nga flakët lokali ku u vra aksidentalisht shqiptari në Athinë, dyshimet e para të autoriteteve gr eke (DETAJE-PAMJE)
ADRESA	https://newsbomb.al/rajon/perfshihet-nga-flaket-lokali-ku-u-vra-aksidentalisht-shqiptari-ne-athine-d-i402159
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 07:22:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 07:14:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	69db30dab0b5559e4dab361e09d1228171eab20cb69dacdb9c81e7950f8b360a
TEKSTI	be3cdef576dfa739f437defe4c4a945eb2534fed13e50a23e3ac48284b6b2cef
PAMJA	679c7b50b747865496e08939e3c8830ab6e2b8cb575033b0dd8c0b6ce4320338

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9c4f80ca8c29fb57b97025136f11c5fce43c915a8b4c1a3546a10bc0c3fdacbc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c6e9ce599dcf050571ac11f5fe8a3879623b3af12e442f4fee76de6471dba328
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9c4f80ca8c29fb57b97025136f11c5fce43c915a8b4c1a3546a10bc0c3fdacbc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Rajoni

28 Shtator 2026, 09:14

Përfshihet nga flakët lokali ku u vra aksidentalisht shqiptari në Athinë, dyshimet e para të autoriteteve greke (DETAJE-PAMJE)



Shkruar nga Newsbomb




Përfshihet nga flakët lokali ku u vra Pëllumb Islami

Është përfshirë nga flakët në orët e para të kësaj të hëne një lokal në zonën e Nea Jonias, në Athinë. Mediat greke raportojnë se pjesa më e madhe e biznesit në fjalë është shkrumbuar ndërsa shtohet se zjarri ka prekur dhe tre banesa që ndodhen në katet e mësipërme të lokalit në fjalë. Sakaq raportohet se bëhet fjalë për lokalin ku më 22 shkurt 2023 u ekzekutua me armë zjarri 39-vjeçari shqiptar Pëllumb Islami.

Autoritetet vendase ndodhen në vendngjarje duke punuar për zbardhjen e potë të rrethanave të ngjarjes, ndërsa deri në këto momente që raportojmë nuk është e sigurt nëse djegia e biznesit ka ndonjë lidhje me vrasjen e Pëllumb Islami.

Gjatë incidentit, banorët e zonës raportuan se nga kati përdeh, aty ku ndodhet dhe lokali, u dëgjua një krismë e fortë. Sakaq bëhet me dije se autoritetet vendase po shqyrtojnë të gjitha mundësitë për shkaqet e zjarrit, përfshirë mundësinë që ai të ketë qenë i lidhur me një bombol gazi, pa përjashtuar mundësinë e zjarrvënies së qëllimshme.

Pamje nga vendngjarja, foto të marra nga newsbomb.gr

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet


Rama i siguroi një vend në politikë Fran Gjakës? Veprimtari pujan u përgjigjet akuzave: Të vërtetën do e mërrni vesh nga unë, jo nga balta e adresave fallo



Kulture & Art

Mbyll sytë përgjithmonë në moshën 75-vjeçare aktori i estradës së Lushnjës, miku zbulon kërkesën e fundit të Robert Kamanit

Zbulo më shumë artikuj >



Po ashtu raportohet se në vendngjarje dolën menjëherë 18 zjarrfikës me pesë automjete, ndërsa në operacion u përdor edhe një automjet special me shkallë. Zjarrfikësit mësohet se kanë ndërhyrë në godinë duke larguar në mënyrë të sigurt persona që ndodheshin brenda ndërtesës së apartamenteve.

Një banore e pallatit, apartamenti i të cilit pësoi dëme të shumta nga zjarri, ka folur për

momentet e tmerrshme që përjetoi.

"Dëgjova një krismë, mendoj se ishte nga koshi që hodhi kamioni i mbeturinave, por menjëherë pas kësaj pashë tym dhe flakë jashtë dhomës. Fillova të bërtisja, burri im mori një fikëse zjarri për të hedhur, i thashë 'hajde të ikim', është shprehur banorja për [newsbomb.gr](https://www.newsbomb.gr).

Vrasja e Pëllumb Islami, ngjarje e ndodhur më 22 shkurt të 2023, ndodhi gjatë një përplasjeje me armë zjarri dhe sherr masiv brenda lokalit midis anëtarëve të një grupi kriminal (i njohur si "Grupi L") dhe personave të tjerë. Islami u qëllua gabimisht teksa se po pinte kafe në tavolinë, pasi nuk ishte i përfshirë në konflikt.

Sipas mediave vendase mësohet se Islami kishte tentuar të qetësonte situatën mes 7 shqiptarëve të cilët po debatnin në lokalin ku 39-vjeçari ishte ulur.

Bashkëshortja e tij ka rrëfyer për mediat greke se Islami u kishte thënë shqiptarëve që të qetësoheshin, por kur kishte parë që ata kishin nxjerrë armët kishte tentuar të largohet me vrap. Në tentativë për të shpëtuar, një plumb qorr i mori jetën 39-vjeçarit.

Autoritetet greke lëshuan disa urdhër-arreste për personat e përfshirë. Një 23-vjeçar shqiptar me dy emra ("Dimitri" dhe "Nektarios") u vetëdorëzua dy muaj pas ngjarjes dhe u përfshi në hetimet e policisë. Sipas hetimeve, autorë të dyshuar për ngjarjen u lidhën me emra si Elis (Erlis) Salaj.

Galeria fotografike ()



Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



5:12:20:43

Aleksandër Vuçiç jep dorëheqjen si president i Serbisë, ua lë "amanet" serbëve: Mos hiqni dorë kurrë nga Kosova!



Rajoni

Fjalimi i fundit si president, Vuçiç i drejtohet serbëve: Faleminderit që qëndruat pranë vendit tuaj

E Diel 20:07



Rajoni

Erdogan i kundërpërgjigjet Netanyahu pas akuzë për "diktator": Vendi i kriminelëve të luftës është në gjykatë

E Shtunë 19:59



E Premte 23:41 Newsbomb

E veçanta e protestës së 10, në ekran shfaqen Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli: Jemi shumë krenarë për atë që kemi bërë për popullin (VIDEO)



Rajoni

Çfarë dihet për zhdukjen e Behar Gjinari, Allaçit dhe çfarë konstatoi Gjykata Speciale

E Enjte 16:26



Rajoni

44-vjeçarja përjeton TMERR, burri e mbyll në shtëpi dhe e kërcënon me th*ke për tre orë, thuhet se dyshja vuan nga shëndeti mendor (DETAJE)

E Mërkurë 21:38 Newsbomb





🕒 E Mërkurë 18:03 Newsbomb

“Jo në emrin tim!” Shqiptarët mblidhen për të tetën herë në Prishtinë, sonte do të

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.